



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	09.02.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-
PËR/ZA/TO:	z. Xhemë Berisha Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Pejësë.
CC:	z. Ali Berisha Kryetar i Komunës së Pejës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Hartimi planit rregullues urban për B.T Rrokaqiell" në Pejë.

I nderuari z. Berisha

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Hartimi planit rregullues urban për B.T Rrokaqiell " në Pejë " numri prokurimit 66100-12-001-421 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Komuna Pejës t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetimin, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Zyra e prokurimit në Komunën e Pejës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Konkurs Projektimit" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 66100-12-001-421 me titull "Hartimi planit rregullues urban për B.T Rrokaqiell" në Pejë , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 7.1 i Dosjes së tenderit te Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 1,2 dhe 3 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar , veç

tjerash, Lista e stafit, Kontratat e OE nga Autoritetet Kontraktuese për 3 vitet e fundit të njëjtës veprimtari, Referencat e O.E mbi ushtrimin profesionale të veprimtarisë të lëshuar nga Institucionet shtetërore ose publike të bashkangjitur me kontratë.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të nenit 23.1 të pikës 4 dhe 5 tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë: "Referencat lidhur me realizimin e projekteve të njëjta " pesha e këtij nën kriteri është 10 % të poentimit, " Përgatitja profesionale e stafit dhe përvoja "pesha e këtij nën kriteri është 10% të poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042 dh

Me respekt!